



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 19 regjistër (JR)  
Datë 12.04.2019

Nr. 18 i vendimit  
Datë 29.07.2020

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ina Rama</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 29.07.2020, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 19/2019 (JR), datë 12.04.2019, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Genci Sinjari, me detyrë gjyqtar dhe kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 66, datë 28.09.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit Genci Sinjari.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 63 dhe 64 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në mungesë të ankuesit, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Genci Sinjari, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, njëkohësisht edhe të kryetarit të kësaj gjykate.
2. Në datën 02.05.2017, z. Genci Sinjari i ka paraqitur Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”) dorëheqjen nga detyra e tij si gjyqtar, për shkaqe shëndetësore dhe familjare.
3. Në datën 09.05.2017, KLD-ja me vendimin nr. 28, vendosi “të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes, për gjyqtarin Genci Sinjari, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, njëkohësisht edhe kryetar i kësaj gjykate”.
4. Në rrethanat e mësipërme, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ndërpreu procesin e rivlerësimit kalimtar të z. Genci Sinjari, me vendimin nr. 66, datë 28.09.2018.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 66, datë 28.09.2018, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës vendosi:
  1. *Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Genci Sinjari, është ndërprerë.*
  2. *Të deklarojë humbjen e së drejtës të subjektit të rivlerësimit për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.*  
*Ky vendim, i arsytuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. [...]*

### III. Shkaqet e ankimit

6. Subjekti i rivlerësimit Genci Sinjari, më datë 29.10.2018, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 66, datë 28.09.2018, duke pretenduar se ky vendim është i pambështetur në ligj dhe në prova dhe, si i tillë, duhet të shfuqizohet.
7. Subjekti i rivlerësimit, ankimin e tij e shoqëroi me disa akte shkresore, në mbështetje të pretendimeve të tij, dhe kërkoi nga Kolegji që, pas shqyrtimit të shkaqeve të ngritura në ankimin e tij, të vendosë:
  - ° *Prishjen e vendimit nr. 66, datë 28.09.2018, të Komisionit dhe vazhdimin e procesit të rivlerësimit për subjektin Genci Sinjari.*
8. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

**8.1** Lidhur me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, subjekti pretendon se me vendimin objekt ankimi i është dhënë një masë disiplinore duke e penalizuar atë pa të drejtë dhe në mungesë të një procesi të rregullt ligjor. Subjekti pretendon gjithashtu se arsyetimi i vendimit të Komisionit është sipërfaqësor.

**8.2** Lidhur me themelin e çështjes, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin G të Aneksit të Kushtetutës, duke i ndërprerë subjektit procesin e rivlerësimit, edhe pse kërkesa e dorëheqjes së tij nga detyra nuk i referohet nenit G të Aneksit të Kushtetutës, sikundër dhe ai nuk ka shfaqur në asnjë moment vullnet për t'u shmangur apo për të ndërprerë procesin e rivlerësimit.

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin Genci Sinjari dhe për të cilin subjekti i rivlerësimit nëpërmjet ankimit kërkon ndryshimin e tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

10. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>1</sup>, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>1</sup> Siç rezulton nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 66, datë 28.09.2018, për rivlerësimin e subjektit Genci Sinjari, i është njoftuar subjektit me anë të shpalljes publike më datë 24.10.2018, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., të datës 22.10.2018, të afishuar pranë Njesisë Administrative nr. {\*\*\*}, Bashkia Berat, pranë adresës së banesës së z. Genci Sinjari në lagjen nr. {\*\*\*}, "{\*\*\*}", rruga "{\*\*\*}", si dhe në këndin e njoftimeve të Komisionit. Ndërkohë ankimi i subjektit të rivlerësimit është depozituar pranë shërbimit postar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës më datë 29.10.2018 dhe ka mbërritur pranë Komisionit më datë 08.11.2018, protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} në të njëjtën datë. Referuar nenit 162 të Kodit të Procedurës Administrative, njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, për rrjedhojë përmbushja e afatit 15-ditor të ankimit sipas nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, do të llogaritet nga kjo datë. Në këto kushte, subjekti rezulton të ketë ushtruar ankim në ditën e 5-të të afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

11. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 66, datë 28.09.2018, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi, nga ku u konstatua se gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, është cenuar e drejta e subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore. Për rrjedhojë, trupi gjykues, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit u njoftua rregullisht për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, në datën 29.07.2020, ora 10:00, por nuk u paraqit dhe as parashtroi ndonjë shkak të arsyeshëm për mungesën e tij. Për rrjedhojë, Kolegji e vazhdoi gjykimin në seancë gjyqësore publike, në mungesë të subjektit të rivlerësimit.

*B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit*

12. Në lidhje me shkakun e ankimit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për të cilin subjekti i rivlerësimit pretendon se me vendimin objekt ankimi i është dhënë një masë disiplinore duke e penalizuar pa të drejtë, në mungesë të një procesi të rregullt ligjor dhe me një vendim të arsyetuar në mënyrë sipërfaqësore, trupi gjykues konstatoi sa vijon.

12.1 Referuar procesverbalit të mbledhjes së zhvilluar nga trupi gjykues i Komisionit, më datë 28.09.2018, dhe përmbajtjes së vendimit nr. 66, datë 28.09.2018, çështja që i përket subjektit të rivlerësimit Genci Sinjari, është shqyrtuar në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në mungesë të seancës dëgjimore me palën e interesuar, subjektin e rivlerësimit Genci Sinjari.

12.2 Me vendimin e sipërcituar, Komisioni ka vendosur ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin Genci Sinjari, si dhe humbjen e së drejtës së tij për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, duke sjellë në këtë mënyrë pasoja të drejtpërdrejta mbi statusin ligjor të subjektit të rivlerësimit.

12.3 Komisioni në vendimin e tij nuk shprehet në asnjë moment lidhur me të drejtën e subjektit për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore, apo rrethanat të cilat legjitimojnë përjashtimin e tij nga kjo e drejtë, referuar rasteve të përcaktuara shprehimisht në nenin 89 të Kodit të Procedurave Administrative, sikundër as në pjesën ku referohet baza ligjore në të cilën mbështetet vendimi i dhënë, nuk referohet asnjë dispozitë ligjore në këtë drejtim.

**12.4** Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit, z. Sinjari, të ketë shprehur në aktin e dorëheqjes së tij drejtuar KLD-së ndonjë mendim<sup>2</sup> në lidhje me procesin e rivlerësimit dhe vullnetin për ta ndërprerë atë, referuar ky në vendimin orientues të Kolegjit nr. 1/2018 (JR), si një kriter, i cili mund ta klasifikojë dorëheqjen e subjekteve nga detyra, si një rast përjashtimor për moskryerjen e seancës dëgjimore nga Komisioni. Për më tepër, trupi gjykues konstatoi që kërkesa për dorëheqje nga detyra nuk është depozituar nga subjekti i rivlerësimit pranë Komisionit, por pranë KLD-së, e cila i ka përcjellë Komisionit praktikën e marrjes së vendimit nr. 28, datë 09.05.2017, “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit dhe mandatit të kryetarit të gjykatës, për shkak dorëheqjeje, të gjyqtarit Genci Sinjari”.

**12.5** Gjithashtu, referuar dokumentacionit të fashikullit të Komisionit, nuk u konstatua as ekzistenca e ndonjë prej rasteve përjashtimore të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 89 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilave procedura administrative mund të mbyllet pa nevojën e njoftimit të subjektit të rivlerësimit dhe pa i dhënë mundësinë këtij të fundit për t’u dëgjuar lidhur me çështjen e tij.

- 13.** Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se, bazuar në rrethanat e këtij rasti, vendimmarrja e Komisionit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin Genci Sinjari dhe ndalimin e ushtrimit të funksioneve të caktuara në nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës për periudhën kohore prej 15 vitesh, në mungesë të njoftimit të subjektit të rivlerësimit dhe pa i dhënë atij të drejtën për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore, në kundërshtim me parashikimet e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me rezultatin e pritshëm të kësaj procedure, përbën cenim të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të cenimit të së drejtës së subjektit të rivlerësimit për t’u dëgjuar lidhur me çështjen e tij, sipas përcaktimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për cenim të procesit të rregullt, si pasojë e cenimit të së drejtës së tij për t’u dëgjuar nga Komisioni para marrjes së vendimit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe ndalimin e tij për ushtrimin e funksioneve të përcaktuara shprehimisht në nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, për një periudhë 15-vjeçare u gjet i drejtë dhe i bazuar.
- 14.** Ndodhur në këto kushte, trupi gjykues, në zbatim të kompetencave korigjuese lidhur me gabimet procedurale të kryera nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, parashikuar shprehimisht në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në zbatim edhe të parashikimeve të nenit 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, duke i garantuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur në mënyrë efektive përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme, lidhur me të gjitha pretendimet e tij mbi procesin e rivlerësimit, të cilat do t’i kishte dhënë përpara Komisionit, në mënyrë të veçantë lidhur

---

<sup>2</sup> Referuar vendimit orientues të Kolegjit nr. 1/2018 (JR), paragrafi 55, në të cilin thuhet:

“Paraqitja sipas ligjit e aktit të dorëheqjes, i jep fund procedurës administrative të rivlerësimit duke mos lejuar kryerjen e veprimeve procedurale të mëtejshme dhe, si e tillë, bën pjesë të rastet përjashtimore, në kushtet kur edhe mendimi i subjektit të rivlerësimit është dhënë në dorëheqjen e paraqitur. [...]”.

me efektet që passjell në ecurinë e procesit të rivlerësimit kalimtar dorëheqja e tij nga detyra e gjyqtarit dhe kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

15. Sa i takon pretendimit të subjektit për cenim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, sipas të cilit Komisioni ka arsytuar në mënyrë të përciptë, pa u thelluar në interpretim të ligjit dhe të provave, nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit të Komisionit, në kuptim të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese<sup>3</sup> lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, trupi gjykues konstatoi se vendimi i Komisionit nr. 66, datë 28.09.2018, sa i takon strukturës së tij, paraqitet në përputhje me elementet e përcaktuara në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, me përjashtim të mendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me procesin e rivlerësimit, moment ky që nuk ka gjetur pasqyrim në vendim dhe vjen si rrjedhojë e mosrespektimit të së drejtës së subjektit për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore. Vendimi rezulton i mbështetur vetëm mbi faktet që kanë rezultuar gjatë procesit në Komision, përmban bazën ligjore (nenin G të Aneksit të Kushtetutës) mbi të cilën është bazuar zgjidhja e çështjes, përmban referencat e nevojshme në ligjin e zbatueshëm, nuk paraqet problematika në drejtim të logjikës, si dhe nuk konstatohen kundërthënie në përmbajtjen e tij. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se vendimi i sipërcituar nuk paraqet problematika në drejtim të standardit të arsytimit, të cilat mund të cenojnë vendimin e Komisionit dhe, për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i bazuar.
16. *Në lidhje me shkakun e ankimit për zbatim në mënyrë të gabuar nga Komisioni të nenit G të Aneksit të Kushtetutës*, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni i ka ndërprerë procesin e rivlerësimit në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi, duke qenë se (i) ai nuk ka bërë kërkesë për dorëheqje në bazë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, por vetëm bazuar në dispozitat e ligjit për statusin e magjistratit për shkak të pamundësisë objektive shëndetësore për të vazhduar aktualisht detyrën (fakt për të cilin ka sjellë bashkë me ankimin edhe dokumentacion shkresor për të provuar shkakun e deklaruar mbi problemet shëndetësore); dhe (ii) ai nuk ka shfaqur vullnet për t'u shmangur apo për të ndërprerë procesin e rivlerësimit. Subjekti pretendon gjithashtu se dispozita së cilës i referohet Komisioni kërkon në mënyrë të qartë që heqja dorë të paraqitet duke shprehur vullnetin për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe që kjo kërkesë të paraqitet para Komisionit.
17. Subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij parashtron se gjatë vitit 2017 ka dorëzuar në afat të gjithë formularët e parashikuar në ligjin nr. 84/2016 lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar dhe në drejtim të sa më sipër, ka sjellë në cilësinë e provës edhe vërtetimin nr. {\*\*\*} prot., datë 26.01.2017, për dorëzimin pranë zyrës së protokoll-arkivit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave të deklaratës së pasurisë *vetting*, si dhe ka kërkuar shprehimisht nga Kolegji vazhdimin e procesit të rivlerësimit.
18. Komisioni në vendimin e tij ka arsytuar lidhur me ndërprerjen e procesit të rivlerësimit si më poshtë:  
*Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen:*

---

<sup>3</sup>Shih vendimet nr. 3, datë 26.01.2015; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 24, datë 25.04.2016; nr. 73, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

*“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.*

*2. Subjekti i rivlerësimit, që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.*

*Me paraqitjen e dosjes, Komisioni është vënë në dijeni të dorëheqjes së subjektit Genci Sinjari “nga funksionet e magjistratit” dhe me vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për mbarimin e këtij statusi.*

*Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njej Kushtetuta për dorëheqje. Kjo sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.*

19. Në shqyrtimin e këtij shkakut të ankimit, trupi gjykues mban parasysh jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit<sup>4</sup>, sipas së cilës akti i dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë humbjen e statusit të tij si subjekt rivlerësimi *ex officio* në kuadër të përcaktimit kushtetues të nenit 179/b të Kushtetutës, si dhe pamundësinë e realizimit të qëllimit të procesit të rivlerësimit, duke pasur parasysh që, referuar nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 58, pika 1, nënparagrafët “a”, “b”, “c” të ligjit nr. 84/2016, qëllimi për kryerjen e procesit të rivlerësimit, i parashikuar në pikën 1 të nenit 179/b të Kushtetutës realizohet, përfundimisht, nëpërmjet konfirmimit në detyrë apo shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Kolegji ka arsyetuar gjithashtu se vullneti për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit sipas përcaktimit të tij në dispozitat kushtetuese dhe ligjin nr. 84/2016, shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit. Në momentin që subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij të lirë ndërpret detyrën funksionale që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, duhet të marrë parasysh edhe pasojën ligjore që sjell dorëheqja nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.
20. Në kuptim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se togfjalëshi “që dorëhiqet sipas kësaj dispozite”, në përmbajtjen e pikës 2 të nenit G, nuk nënkupton vendosjen e një kriteri kushtetues sipas të cilit aplikimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës kushtëzohet me referimin apo jo të kësaj dispozite kushtetuese në aktin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit. Në të njëjtën frymë arsyeton edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 78 datë 12.12.2017, tek shprehet: *Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.*
21. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues çmon që, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit dorëheqjen e tij nuk e ka bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, sikundër edhe nëse do të provohej se

<sup>4</sup> Shih vendimin e Kolegjit nr. 17/2019 (JR), paragrafët 21.3 dhe 21.4.

shkaku i dorëheqjes së tij nga detyra ishte shkak objektiv (shkak shëndetësor, sikurse pretenduar nga subjekti i rivlerësimit), këto fakte vlerësohen pa efekt në drejtim të zbatimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë subjekti i rivlerësimit, si pasojë e dorëheqjes së tij nga detyra që ushtronte në periudhën gjatë së cilës kryhej procesi i rivlerësimit<sup>5</sup>, ka humbur statusin e magjistratit, sipas neneve 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, deklaruar kjo me vendimin nr. 28, datë 09.05.2017, të KLD-së. Ky fakt ka sjellë si pasojë edhe humbjen e statusit si subjekt rivlerësimi *ex officio*, në kuadër të parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës. Për rrjedhojë, edhe aktet e dorëzuara bashkëlidhur ankimit të cilat konsistojnë në dokumente që provojnë ekzistencën e problemeve shëndetësore apo edhe kopja e vërtetimit që provon dorëzimin pranë ILDKPKI-së të deklaratës së pasurisë *vetting* vlerësohen nga trupi gjykues si akte të cilat provojnë fakte të parëndësishme për marrjen e vendimit, në përputhje me nenin 49, pika 6, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

22. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ai nuk ka shfaqur në asnjë moment vullnet për t’iu shmangur apo për të ndërprerë procesin e rivlerësimit edhe për faktin se dorëheqja nga detyra është rrjedhojë e pamundësisë së ushtrimit të detyrës për shkaqe shëndetësore, trupi gjykues, në konsideratë të parashikimeve ligjore në fuqi, konkretisht nenit 24 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili i jepte mundësinë subjektit të rivlerësimit të përfitonte leje të papaguar deri në 2 vite, për arsye familjare ose shëndetësore, pa cenuar statusin e tij të magjistratit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit i kishte hapësirat e nevojshme ligjore për të demonstruar vullnetin e tij për vazhdimin e procesit të rivlerësimit, por përkundrazi ai zgjodhi të dorëhiqet nga detyra e gjyqtarit, sipas nenit 65 të të njëjtit ligj, akt ky që sipas legjislacionit të zbatueshëm do të prodhonte si efekt ligjor ndërprerjen e procesit të rivlerësimit në përputhje me nenin G të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i bazuar nga trupi gjykues.
23. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për zbatim të gabuar të nenit G të Aneksit të Kushtetutës gjendet i pabazuar dhe, për rrjedhojë, vendimi i Komisionit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me nenin G të Aneksit të Kushtetutës.
24. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, pas verifikimit të situatës faktike nëpërmjet çmuarjes së provave të administruara gjatë procesit të hetimit nga Komisioni, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, trupi gjykues arrin në konkluzionin se vendimi i Komisionit është i drejtë, i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

---

<sup>5</sup> Akti i dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit nga detyra e gjyqtarit dhe e kryetarit të gjykatës mban datën 17.04.2017 dhe është protokolluar në KLD më datë 02.05.2017.



## **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 66, datë 28.09.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Genci Sinjari.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 29.07.2020, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*